



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS/ SUDSKI SAVET KOSOVO/ KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



SEKRETARATI I KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

GYKATA SUPREME E KOSOVËS

Sheji i shkresës
Oznaka spisa:

AA-16/2017

FLETËDËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL DOSTAVNICA ZA-LICNO DOSTAVLANJE

PZA P

1. Pasi marrësi, I cili me teminim e parë të dorëzimit nuk u gjëti në vendin e ku është dashtë të bëhet dorëzimi I sa pas lehtës së lajmërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës, së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërsesës, fëmijë, personit që punon po në atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatecen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obavestjenja da radi dostavljanja bude u određeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena; odaslom članu domaćin. Primaoca nastojnikki zgrace susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca (~~primilac~~ primaoca stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më _____ 201 _____ në ora _____
dana _____ u _____
Shkaku i refuzimit të marrjes _____
Razlog odbijanja prijmea _____



16-09-2017

Prishtinë / Pristina

Nënskrimi i dorëzuesit - popis dostavljač
Nr./Br. _____
Nënskrimi i dorëzuesit - popis dostavljaca

Emri i shkresës që dorëzohet: _____
Nasllov pisma koja se dostavlja: _____
Emri i shtojcave: _____
broj prijloga _____

Vërtetoi se mora shkresën e lartpërmendur
më (me fjalë) _____
Povrdjemo prijem gorenavegenog pisma
(i stovim) 16.09.2017 ona KSA

(Nënskrimi i marrësit ose i atij që
e ka marrë aktin në vend të tij
Popis primaoca ili licu koje je
pismeno primilo u znanju)

AKO

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesi, duke shënuar shkaku në marrësi nuk e ka vënë nënskrimin e vet. Ako je primilac nepismen ili nije u stanju da se potpise, potpisuje ga dostaljac, napomenomi žasto primilac nije stavio svoj potpis.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

AA. nr. 16 / 2017

Më 16.09. /2017
Prishtinë

PZAP - Prishtinë

Pranë kësaj Gjykate

ZAFIR BERISHA

nga Prizreni

ka ushtruar ankesë kundër vendimit

PZAP

Në përputhje me nenin 37 . 1 të Ligjit për Konflike Administrative, ju dërgojmë një ekzemplar të padisë që të jepni përgjigje ndaj padisë dhe kërkojmë të na i dërgoni shkreat e lëndës që të mund të vendosim përkitazi me padinë.



Gjyqtari,


PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)

Prishtinë

Për

GJYKATËN SUPREME TË KOSOVËS

Prishtinë



Kundër Vendimit të Panelit zgjedhor për ankesa dhe parashtresa (PZAP)nr. ZI. Anr, 18/2017 datë 15.09.2017, apeluesi Zafir Berisha nga Prizreni, si I decertifikuar për kandidat për Kryetar të Komunës së Prizrenit nga Subjekti politik Nisma për Kosovën-NISMA , në afatin e caktuar parashtron

ANKESË

Me të cilën në tërësi e ankimon Vendimin e Panelit zgjedhor për ankesa dhe parashtresa (PZAP)nr. ZI. Anr, 18/2017 datë 15.09.2017 duke propozuar që i njëjti si kundërligjor të anulohet në tërësi, për shkak të

- Vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe
- Aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

A r s y e t

Me Vendimin e Panelit zgjedhor për ankesa dhe parashtresa (PZAP)nr. ZI. Anr, 18/2017 datë 15.09.2017 është refuzuar si i pa bazuar apeli – ankesa e Zafir Berishës për anulimin e vendimit nr. 1623-2017 datë 12,09,2017 i Komisionit qendror të Zgjedhjeve me seli në Prishtinë me të cilin parashtruesi i ankesës është DECERTIFIKUAR si kandidat për kryetar të Komunës së Prizrenit, nga subjekti politik NISMA, për zgjedhjet Lokale që do të mbahen më datë 22.10.2017.

- Vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike

Me vendimin e ankimuar të Panelit zgjedhor për ankesa dhe parashtresa (PZAP)nr. Zl. Anr, 18/2017 datë 15.09.2017 gabimisht është vërtetuar gjendja faktike.

Vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike qëndron në atë se nuk janë plotësuar kushtet ligjor për decertifikimin e ankuesit Zafir Berisha për kandidat për kryetar të Komunës së Prizrenit, nga subjekti politik NISMA, për zgjedhjet Lokale që do të mbahen më datë 22.10.2017.

Në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren P.nr. 504/2014 datë 20.08.2015 i formës së prerë më 12.10.2015 është gjykuar me dënim vetëm me gjobë në lartësi prej 140,00€ edhe me asnjë dënim plotësues.

Një dënim i tillë nga Gjykata Themelore në Prizren i kandidati Zafir Berisha si kandidat për kryetar të Komunës së Prizrenit, nga subjekti politik NISMA, për zgjedhjet Lokale që do të mbahen më datë 22.10.2017, nuk është kusht ligjor që apeluesi Zafir Berisha të decertifikohet nga kandidati për kryetar të komunës së Prizrenit për zgjedhjet lokale të cilat do të mbahen më datë 22.10.2017 **ngase në bazë të nenit 100 § 2 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës “Pasojat juridike të dënimit nuk krijohen kur kryerësit i shqiptohet gjoba, dënimi me kusht apo vërejtja gjyqësore ose kur kryerësi lirohet nga dënimi”.**

Po ashtu me Nenin 63 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës **“Gjykata ia heq kryerësit të veprës penale të drejtën për tu zgjedhur për 1(një) deri në 4(katër) vjet, nëse ai person, me qëllim që të zgjidhet, kryen ndonjë nga veprat penale kundër të drejtave të votimit ose vepër tjetër penale për të cilën është paraparë dënimi më së paku dy (2) vjet burgim”.**

Pra as me dispozitën e Nenit të përmendur nuk janë plotësuar kushtet ligjor për decertifikimin e ankuesit Zafir Berisha dhe se edhe në këtë Vendimi i ankimuar i Panelit zgjedhor për Ankesa dhe parashtresa Izl.Anr. 18/2017 datë 15.09.2017 është kundërligjor dhe i njëjti si i tillë nuk mund të qëndroj.

Po ashtu Vendimi i ankimuar i organit të shkallës së dytë është në kundërshtim edhe me dispozitat e nenit 45 § 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës me të cilën është përcaktuar se:

“1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë kufizohet me vendim gjyqësor”.

Tek ankuesi Zafir Berisha dispozita e përmendur kushtetuese si akt i përgjithshëm juridik në parimin *lex specialis derogat legi generali* përjashtohet me dispozitat e Kodit Penal të Republikës së Kosovës neni 100 § 2 dhe Neni 63 siç i arsyetova më parë ngase

dënimi me gjobë i Gjykatës Themelore në Prizren kandidatin Zafir Berisha këtu ankuesin nuk e decertifon për shkaqet e përmendura ligjore.

Po ashtu në bazë të nenit 29 § 1 pika nën p/ përcaktohet se cilido person emri i të cilit parqitet në Listën e votueseve është i aftë për certifikim si kandidat përveç nëse ai apo ajo (pika nën p/) me anë të vendimit të gjykatës, i është hequr e drejta për të qenë kandidat , e që në rastin e ankuesit Zafir Berisha nuk qëndron ngase me asnjë vendim të gjykatës nuk i është hequr e drejta për të qenë kandidat e as me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren P.nr. 504/2014 datë 20.08.2015 i formës së prerë më 12.10.2015 por vetëm iu ka shqiptuar dënimi vetëm me gjobë i cili dënim nuk e kushtëzon DECERTIFIKIMIN e vërtetuar nga organi i Shkallës së dytë me Vendimin e ankimuar ZI. Anr, 18/2017 datë 15.09.2017. siq gabimisht merret nga Organi i Shkallës së dytë me Vendimin e ankimuar.

Po ashtu Organi i Shkallës së dytë Paneli gabimisht dhe kundërligjshëm është e refuzon ankesën e ankuesit Zafir Berisha duke u bazuar në nenin 29 paragrafi 29.1 pika nën " q/ i shpallur fajtor për vepër penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri (3) vitet e fundit" në të cilën po ashtu gabimisht e refuzon Paneli ankesën e Zafir Berishës ngase për këtë e sqarova më parë se dënimi me gjobë nuk prodhon pasoja juridike në kuptim të nenit 100 § 2 (ngase pasojat juridike të dënimi nuk krijohen kur kryerësit i shqiptohet gjoba, dënimi me kusht apo vërejtja gjyqësore ose kur kryerësi lirohet nga dënimi" e as nuk iu ka shqiptuar ankuesit Zafir Berisha dënimi plotësues.

Me vërtetim të gabuar të gjendjes faktike Vendimi i Panelit si organ i shkallës së dytë nuk mund të qëndroj.

- **Shkelja e ligjit**

PZAP si organ i shkallës së dytë me refuzimin e ankesës të Zafir Berishës si ankues gabimisht i ka aplikua dispozitat e Nenit 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 100 §2 të KPenal të republikës së Kosovës si dhe dispozitat e Nenit 29 § 29.1 pika nën p/ dhe q/ të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në republikën e Kosovë dhe me një aplikimi të gabuar të së drejtës materiale vendimi i ankimuar nuk mund të qëndroj.

Prizren,
16.09.2017.

ANUKESI,
Zafir Berisha

RD. BESIM SHKALLA
PRIZREN




3

099808022



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Me, 12.09.2017

Në bazë të autorizimeve të përcaktuara me nenin 63.4, nenin 28, nenin 29 par. 1 pika q), nenin 29.4 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 14 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve** me datë 12.09.2017 merre këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet rekomandimi i Zyrës për decertifikim të Kandidatit z. Zafir Berisha nga partia politike "Nisma për Kosoven" nga gara për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më 22 Tetor 2017.
- II. Obligohet Zyra që ta njoftoj z. Zafir Berisha për marrjen e këtij Vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duke u bazuar në nenin nenit 29 par. 1 pika q) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, ka paraqitur kërkesë Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për verifikimin e kandidatëve që marrin pjesë në garat zgjedhore për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen më 22 tetor 2017, nëse të njëjtit janë të dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm nga Gjykatat e Republikës së Kosovës, në tre (3) vitet e fundit, respektivisht në mes të datës 22 gusht 2014 – 22 gusht 2017, kur edhe ka përfunduar afati për aplikim për certifikim. Neni 29 i LPZ parasheh kushtet për përshtatshmërinë/afësinë e kandidatit për të qenë i aftë të certifikohet si kandidat. Me par.1 pika q të po këtij neni është parashikuar që në mes të tjera kushteve të cilat duhen të përmbushen, kandidati duhet mos të jetë i shpallur fajtor për vepër penale me një vendim përfundimtar të Gjykatës në tre (3) vitet e fundit.


Këshilli Gjyqësor është përgjigjur dhe ka dorëzuar kopjen e Aktgjykimit nga Gjykata Themelore në Prizren, ku rezulton se kandidati z. Zafir Berisha është i dënuar për vepër penale në bazë të aktgjykimit P.nr. 504/2014 të dt. 20.8.2015 i cili aktgjykim është bërë i plotfuqishëm më 12.10.2015, pra në afatin e përcaktuar më lart.

Duke u nisur nga këto që u tha më lartë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mori vendim që kandidati z. Zafir Berisha, të decertifikohet, e duke u bazuar në nenin 29 par.4 të Ligjit për zgjedhjet e Përgjithshme i cili nen parasheh që "nëse

kandidati i cili është certifikuar nga KQZ është apo ka arritur statusin sipas të cilit ai apo ajo humb aftësinë për të qenë kandidat sipas dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni, ai person decertifikohet nga KQZ dhe largohet nga lista e kandidatëve të subjektit politik në fjalë.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankesë në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa-PZAP, në afat prej 24 orëve nga marrja e këtij vendimi.

Kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve



Valdete DAKA

Për: Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - Prishtinë

Nga: Zafir Berusha - Prizren

Më: 13.09.2017

Lënda: Ankesë Kundër Vendimit të KQZ-së NR. 1623 - 2017, i datës 12.09.2017 për decertifikimin e kandidatit për Kryetar të Komunës së Prizrenit nga Subjekti Politik Nisma për Kosovën - NISMA,

Bazuar në nenin 15 të Ligjit Nr.03/L-256 që ka të bëjë me të Plotësim Ndryshimit të Ligjit NR.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe të nenit 122 paragrafi 1, pika c, në afatin e parapar ligjor, si kandidat i subjektit politik të NISMAS, parashtroj:

ANKESË

Kundër Vendimit Nr. 1623-2017, datë 12. 09. 2017 të KQZ për decertifikimin tim si kandidat për Kryetar të Komunës së Prizrenit.

Me këtë vendim konsideroj se komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka bërë shkelje të:

- dispozitave të Kushtetutës që kanë të bëjnë me të drejtën zgjedhore dhe të pjesëmarrjes dhe
- ka bërë vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike.

Neni 29 paragrafi 1 pika nën q) ku është bazuar vendimi i KQZ për decertifikim e i cili thotë citoj: “ cilido person emri i të cilit paraqitet në Listën e Votuesve është i aftë për certifikim si kandidat përveq nëse ai apo ajo është: shpallur fajtor për vepër penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri (3) vitet e fundit.

Konsiderojmë se vendimi i sipërcituar bie ndesh dhe shkel dispozitën Kushtetuese përkatësisht nenit 45 paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës i cili thotë, citoj: “ Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën 18 vjeç qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedh dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor.

Kjo e drejtë kushtetuese nuk më është hequr me asnjë denim apo vendim të gjykatës qoft si denim kryesor apo plotësues në kuptim të nenit nenit 62 paragrafi 2 pika 1 i Kodit Penal dhe as nuk më është hequr e drejta për tu zgjedhur sipas nenit 63 të këtij kodi.

Gjykata Themelore në Prizren me rastin e shqyrtimit të kërkesës së KQZ-së në rastin tim konsideroj se nuk ka vepruar drejtë dhe nuk e ka përfillë edhe nenin 100 paragrafi 2 që ka të bëjë me pasojat juridike të denimit. Ky nen në paragrafin 2 të sipërcituar thot:” pasojat juridike të dënimit nuk krijohen kur kryesit i shqiptohet gjoba, denimi me kusht apo vërejtja gjyqësore ose kur kryesi lirohet nga denimi “. Sikurse, KQZ-ja në bazë të nenit 100, paragrafi 2 të kodit penal ka qenë dashur ta marrë parasysh me rastin e marrjes së vendimit për decertifikimin e kandidatëve, duke ju referuar mungesdës së pasojave juridike të dënimeve në përputhje me këtë nen.

KQZ në rastin konkret me vendimin për decertifikimin e kandidatëve ka bërë zbatim selektiv të kësaj dispozite ligjore për shkak se që nga hyrja në fuqi e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme asnjëherë të vetme nuk e ka kërkuar verifikimin e kandidatëve për zgjedhjet që ka organizuar qofshin qendrore apo lokale përfshirë edhe zgjedhjet e 11 qershorit 2017, ku nga këto zgjedhje jam zgjedhur deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Moszbatimi i kësaj dispozite ligjore duhet ta sjell para përgjegjësisë edhe KQZ poashtu edhe vet akti i votimit për këtë çështje konsideroj se është atilgjor dhe me tendencë denigruese për personalitetin tim., nga se dispozitat ligjore duhet zbatuar nga institucioni në fjal dhe jo të votohen ato.

KQZ e ka shkelë vet Ligjin për Zgjedhjet se pas certifikimit të Subjekteve politike dhe kandidatëve me datë 30.08.2017 ka marrë vendim për decertifikim.

Me këtë rast Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kan cënuar dinjitetin tim i cili është bazament i të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut i garantuar me dispozita kushtetuese në nenin 45, 55.4 dhe 23 të saj.

Bazuar në këtë kërkoj nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe parashtresa të bëjë anulimin e vendimit të KQZ-së Nr.1623 – 2017 të datës 12.09.2017 dhe rikthimin tim në garë zgjedhore si kandidat për Kryetar të Komunës së Prizrenit.

Të bashkangjitur kenî:


- Vendimi për decerifikim Nr. 1623 – 2017 datë 12.09.2917
- Aktgjykimi i Gjykatës themelore në Prizren
- Vendimi për certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve nr datë 30.08.2017

Kontakti: 044 80 80 22

Adresa: rr. "Besim Shala" 66 Prizren

Me respekt,

Zafir Berisha

A handwritten signature in black ink, consisting of several overlapping loops and a long horizontal stroke extending to the right. The signature is positioned above a thin horizontal line.



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.18/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fitore Isufi, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Zafir Berisha kandidat për kryetar të Komunës së Prizrenit, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), me nr. protokoli 1623-2017 të datës 12.09.2017, për shkak të decertifikimit nga gara për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale 2017, për Kuvendin Komunal në Prizren, në seancën e panelit të mbajtur me 15.09.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i Zafir Berisha, për anulimin e vendimit Nr. 1623-2017 të datës 12.09.2017, i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, me të cilin, parashtruesi i apelit është decertifikuar si kandidat për kryetar të Komunës së Prizrenit, nga subjekti politik NISMA, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

Parashtruesi i apelit Zafir Berisha nga subjekti politik NISMA, më datë 13.09.2017 ka paraqitur një apel në PZAP, kundër vendimit të KQZ-së nr. protokoli 1623-2017 të datës 12.09.2017, me të cilin pretendon se KQZ-ja e ka decertifikuar nga lista e kandidatëve për kryetar në Kuvendin Komunal, duke shkëlur të drejtën e garantuar me nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Andaj parashtruesi i apelit kërkon nga PZAP-i që ta anulon vendimin Nr.1623-2017 të datës 12.09.2017 të KQZ-së, lidhur me decertifikimin e tij nga gara si kandidat për kryetar të Kuvendit Komunal të NISMA-s, pasi që i njëjti pretendon, se KQZ ka shkëlur dispozitat e Kushtetutës që kanë të bëjnë me të drejtën zgjedhore dhe të pjesëmarrjes, si dhe ka bërë vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike.

Parashtruesi i apelit gjithashtu pretendon, se asnjëherë nuk i është hequr e drejta kushtetuese, me asnjë dënim apo vendim të gjykatës dhe as e drejta për tu zgjedhur. Për më tepër thekson, se KQZ asnjëherë nuk e ka kërkuar verifikimin e kandidatëve qofshin zgjedhjet qendrore apo lokale, dhe se në Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare të 11 qershorit 2017, është zgjedhur deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Andaj këtu KQZ ka shkel Ligjin për Zgjedhjet, pasi që pas certifikimit të Subjekteve Politike dhe kandidatëve me datë 30.08.2017, ka marr vendim për decertifikim, siç pretendon parashtruesi i apelit.

KQZ-ja në përgjigjen në ankesë ka theksuar, se ka kërkuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës që të bëjë verifikimin e kandidatëve që marrin pjesë në garat zgjedhore për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen me 22 tetor 2017, nëse të njëjtit janë dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm nga Gjykatat e Republikës së Kosovës. Në këtë rast Zafir Berisha, kandidat për kryetar të Komunës së Prizrenit nga subjekti politik NISMA, është i dënuar për vepër penale, në bazë të Aktgjykimit P.nr 504/14 të datës 20.08.2015 të Gjykatës Themelore në Prizren, e i cili Aktgjykim është bërë i plotfuqishëm me datën 12.10.2015. Andaj KQZ-ja pretendon në përgjigjen në apel se ka vepruar konform nenit 29.4 LZP-së, me rastin e marrjes së vendimit nr. 1623-2017, që kandidati Zafir Berisha të decertifikohet si kandidat i listës së subjektit politik NISMA, me propozim për panelin e PZAP-it, që apeli të refuzohet si i pabazuar.

Ndërsa sa i përket pretendimit lidhur me atë se KQZ asnjëherë nuk e ka kërkuar verifikimin e kandidatëve, KQZ në përgjigjen në apel thekson se të gjithë kandidatët nën përgjegjësinë morale dhe penale kanë nënshkruar formularin për certifikim të kandidatit, ku kanë deklaruar se janë njoftuar me nenin 29 dhe se i përmbushin të gjitha kushtet sipas këtij neni.

Paneli pasi që shqyrtoj dhe vlerësoj gjitha pretendimet e apelit, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, vlerësoj lejueshmërinë e apelit dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 122 të LZP-së dhe nenin 10 të Rregullës Nr. 02/2015- Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të apelit se me rastin e marrjes së vendimit Nr. 1623-2017 datë 12.09.2017 nga KQZ-ja, lidhur me de certifikimin e tij nga gara e listës së kandidatëve për kryetar të Kuvendit Komunal në Prizren, ju është shkelë e drejta e garantuar me Kushtetutë. Paneli vlerëson se pretendimet e parashtruesit të apelit janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara në ligj, sepse neni 29 par.1 pika q) i LZP-së, për cakton se cili do person, emri i të cilit paraqitet në Listën e Votuesve, është i aftë për certifikim, përveç nëse personi është shpallur fajtor për vepër penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri (3) vitet e fundit, siç edhe është në rastin konkret ngase aktgjykimi P.nr 504/14 të datës 20.08.2015 të Gjykatës Themelore në Prizren është bërë i plotfuqishëm me datën 12.10.2015, është shpallur fajtor për vepër penale në tre vitet e fundit para certifikimit.

Mbi këtë bazë, Paneli konstaton se KQZ-ja, me rastin e marrjes së vendimit Nr. 1623-2017 datë 12.09.2017, drejt ka zbatuar dispozitën ligjore të nenit 29 par. 4 të LZP-së, pasi që i njëjti është shpallur fajtor për vepër penale me aktgjykim përfundimtar në tri (3) vitet e fundit, sipas aktgjykimit, P.nr 504/14 të datës 20.08.2015 të Gjykatës Themelore në Prizren, është bërë i plotfuqishëm me datën 12.10.2015. Mbi këtë bazë vendimi i KQZ-së, për de certifikimin e

apeluesit dhe largimin e tij nga lista e kandidatëve të subjektit politik, është i ligjshëm dhe çdo pretendim në apel mbi këtë bazë është i paqëndrueshëm.

Paneli me rastin e vendosjes mori parasysh edhe dispozitën e nenit 45 par.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në të cilin përcaktohet se: *"Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën 18 vjeç, qoftë edhe në ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor"*. Kjo e drejtë e garantuar me kushtetutë, parashtruesit të apelit nuk ju është kufizuar me vendimin e ankimuar të KQZ-së, pasi që pikërisht me nenin 55 par.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është përcaktuar se: *"Te drejtat dhe liritë themelore të garantuar me këtë Kushtetutë mund të kufizohen vetëm me ligj"*. Ndërsa, në rastin konkret kjo e drejtë parashtruesit të apelit për tu zgjedhur ju është kufizuar me nenin 29 par.4, të LZP-së, pasi që parashtruesi i apelit e ka humbur aftësinë për të qenë kandidat sipas nenin 29 par.1 pika q), të LZP-së.

Sipas vlerësimit të panelit edhe përmbajtja e dispozitës së nenit 45 të Kushtetutës, *"gëzon të drejtën të zgjedh dhe të zgjedhet me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor"* është komentuar, në komentarin e Gjykatës Kushtetuese¹, në këtë rast kemi të bëjmë me formën e dytë të mbrojtjes gjyqësore të kësaj të drejte, në kuptimin që Kushtetuta në këtë paragraf të nenit 45 paraqet prezumime për vendosjen e disa shkallëve dhe të formave të mbrojtjes së kësaj të drejte, e cila më vonë rregullohet me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë. Në vështrim të këtij Ligji, shkalla e parë dhe forma e mbrojtjes së kësaj të drejte është mbrojtja administrative brenda Komisionit Qendror Zgjedhor (neni 64 lidhur me nenin 98); e dyta është në PZAP si institucion i përhershëm dhe i pavaruar në përbërje prej gjyqtarëve (105;118-119), ndërsa e treta është mbrojtja e plotë gjyqësore në Gjykatën Supreme të Kosovës (neni 118.4)". Nga kjo rezulton se mbrojtja e të drejtës gjyqësore e garantuar me Kushtetutë konsumohet me vendimin e PZAP-së dhe mundësinë që i njëjti të ankimohej në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par.3, 118 par.1, 122 par.1 pika b) të LZP-së, si dhe nenit 11 par.6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa
ZL A nr. 18/2017 më datën 15.09.2017.



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.

¹ Enver Hasani & Ivan Čukalović, Komentari i Kushtetutes së Republikës së Kosovës, fq.159-167, dhjetor 2013.

P.nr.504/15
PP.nr.389/14

PROÇESVERBALMI SHQYRTIMIN FILLESTAR
I mbajtur pranë Gjykatës Themelore në Prizren me datë 20.08.2015

Përbërja e trupit gjykues:
Gjyqtari Gjykues
Refki Piraj

Prokurori i shtetit
Elfete Purova

I AKUZUARI:
Zafir Berisha

Mbrojtësi
Skender Morina

Procesmbajtësja,
Sheqere Braha

**Lënda e shqyrtimi, vepra penale nga
nga neni 321 të KP.**

*shqyrtimi fillon
në ora 10:30. minuta*
Shqyrtimi është publik

Gjykata konstaton se në shqyrtimin fillestar prezenton prokurorja e Shtetit Elfete Purova, si dhe i akuzuari Zafir Berisha, dhe mbrojtësi i tij av.Skender Morina.

Gjykata konstaton se janë plotësuar kushtet ligjore, për mbajtjen e shqyrtimit.

Gjykata mer

V E N D I M

Shqyrtimi fillestar mund të fillojë në çështjen penale të pandehurit.

Shqyrtimi është publik.

Nga i pandehuri miren shenimet personale.

I pandehuri Zafir Berisha, nga i ati Halim dhe e ëma Rahime e lindur Krasniqi, i lindur më 16.01.1968 në fshatin Billushë Komuna e Prizrenit, me profesion arsimtar, i martuar – baba i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës.

Pyetet i pandehuri se a e ka pranuar kopjen e aktakuzës .

Te pandehurit deklarohet se e ka pranuar dhe e ka kuptuar.

Shqyrtimi fillestar fillon me leximin e aktakuzës PP.nr.389/14 të datës 27.03.2014, të cilën e lexon PSH Elfete Purova, e cila deklarohet se meqenëse në kallximin penal të parashtruar nga ana e të dëmtuarës KEDS qëndron edhe vepra penale heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare nga neni 414 i KP pas vlerësimit të provave konsiderojmë se janë formuar elementet e vprës penale vetëm të heqjes apo dëmtimit të vulave zyrtare nga neni 414 e jo edhe lidhje pa autorizuar të shërbimeve nga neni 321 të KP, për këtë edhe bëjmë rikualifikimin e vprës penale nga neni 321 në nenin 414 i KP.

U lexua aktakuza.

Pas keshillimit që i bëhet te pandehurit se ka mundësi të mbrohet në heshtje, ka mundësi të mos përgjigjet në pyetje dhe të mos inkriminojë veten dhe antarët e ngushtë të familjes si dhe ka të drejtë të kundërshtoj propozim akuzën ka të drejtë të angazhojë mbrojtës i cili deklarohet se nuk dëshiron të angazhojë mbrojtës.

Ftohet i pandehuri Zafir Berisha, që të deklarohet se a e pranon fajësinë si në aktakuzë .

I njëjti deklarohet se e pranon fajësinë si në aktakuzë.

Pasi të akuzuarit i shpjegohet natyra dhe pasojat e pranimit të fajësisë si dhe rrethanën se me rastin e pranimit do të ketë lehtësime në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit.

Prokurorja e Shtetit nuk ka ndonjë çështje të veçantë rreth pranimit të fajësise.

Gjyqtari i vetëm gjykues gjen se pranimi i fajësisë është bërë në pajtim me dispozitat e KPPsë, andaj dhe aprovohet pranimi i fajësise si i tillë.

Gjykata mer

A K T V E N D I M

APROVOHET pranimi i fajësisë nga ana e te pandehurit Zafir Berisha, për këtë me tutje do te veprohet ne pajtim me dispozitat per pranimin e fajësisë gjate shqyrtimit fillestar.

Per ketë gjykata i bie kete

A K T G J Y K I M

I pandehurit me shenime si ne shkresat e lendes

ËSHTË FAJTOR

Se prej datës së pavërtetuar deri më datën 31.01.2014 në fshatin Vlashnje Komuna e Prizrenit, pikërisht në lokalin e tij afarist restorant “Kështjella” lidhet apo rilidhet me përquesin e rrymës elektrike apo në rrjetin për përçim apo shpërndarje të çfardo shërbimi komunal në çfardo mënyre, drejtpërdrejtë apo tërthorazi pa autorizim të furnizuesit të autorizuar në atë mënyrë që edhe pse është çkyqur nga njëtori ka bërë rikyqje ilegale në shtyllë pa autorizimin e organit kompetent respektivisht KEDS-Distrikti në Prizren.

-Këso dore ka kryr veprën penale heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 414 i KP.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 3, 4, 41, 43, 46, te KP_së. te akuzuarit i shqipton :

DENIM ME GJOBË

Me të holla në shumë prej 140 Euro, të cilin denim do ta paguajë në xhirollogarinë e kësaj gjykate nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. E poqese dënimi me të holla nuk mund të paguhet nga ana e të akuzuarit I njejt i do të zëvendësohet me denim burgu duke llogaritur 20 Euro një ditë burg gjegjësisht 7 ditë burg.

Obligohet i pandehuri qe ti paguaj te gjitha shpenzimet e procedurës penale sa ato bëhen ne baze te llogarisë se gjykatës, kurse ne emër te te paushallit gjyqësor shumen prej 20 euro, gjitha keto ne afat prej 15 ditesh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi nen kërcënim te ekzekutimit te dhunshëm.

A r ë s y e t i m

Si në përshkrim te aktgjykimit.

Pas shpalljes se aktgjykimit gjyqtari i udhezoi palet per te drejten ne ankes .

Mbaroi ne oren 11:00.

I pandehuri:

Prokurori i shtetit

V E R T E T O J N Ë

Procesmbjatesi
Sheqere Braha

Gjyqtari
Refki Piraj